

Treguesit e Shëndetit Publik

Viti 2022

Tiranë, më 10 2023: Në vitin 2022, numri i vizitave gjithsej në shërbimin parësor ishte 8.434.996, mesatarisht 3 kontakte për person në vit. Numri i vizitave shënoi një rritje me 3,6 %, krahasuar me numrin e vizitave në vitin paraardhës. Gjatë vitit 2022, ditët mesatare të qëndrimit të një pacienti në spital ishin 4,6 ditë. Në institucionet publike të shërbimit spitalor janë kryer 63.862 ndërhyrje kirurgjikale, 12,8 % më shumë, krahasuar me një vit më parë.

I. Kujdesi shëndetësor parësor


Në vitin 2022, nga 8.434.996 vizita gjithsej në shërbimin parësor, 41,5 % u kryen në qendrat shëndetësore, 23,2 % në ambulanca dhe 35,2 % në poliklinika. Përgjatë 5 viteve të fundit, vihet re pothuasje e njëjta shpërndarje në numrin e vizitave. Mbi 40 % e vizitave në qendrat shëndetësore dhe ambulancat u realizuan nga personat mbi 60 vjeç.

Tab. 1 Aktiviteti i Qendrave Shëndetësore, Ambulancave dhe Poliklinikave

Emërtimi	Vitet				
	2018	2019	2020	2021	2022
Vizita gjithsej	8.219.771	7.650.504	7.353.296	8.144.504	8.434.996
Numri i vizitave në qendra shëndetësore	3.411.915	3.374.429	3.149.495	3.482.174	3.501.358
Numri i vizitave në ambulanca	1.541.645	1.543.269	1.510.006	1.650.378	1.961.026
Numri i vizitave në poliklinika	3.266.211	2.732.806	2.693.795	3.011.952	2.972.612

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Fig. 1 Shpërndarja e vizitave të kryera dhe numri mesatar i kontakteve në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Konsultori i gruas

Në vitin 2022, numri i vizitave në konsultorin e gruas ishte 220.074, duke shënuar një rënie me 2,1 %, krahasuar me vitin 2021. Nga totali i vizitave, 20,2 % ishin vizita gjinekologjike dhe 79,8 % ishin vizita obsetrikale. 56 % e vizitave obsetrikale u realizuan me asistencë të mjekut specialist.

Numri i vizitave të para-obsetrikale ishte 23.444, me një rënie me 9,5 %, krahasuar me vitin 2021.

Tab. 2 Konsultori i Gruas

Emërtimi	Vitet				
	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i vizitave gjithsej	243.594	206.326	212.400	224.790	220.074
Numri i vizitave gjinekologjike	46.372	38.981	30.231	41.647	44.514
Numri i vizitave obsetrikale	197.222	167.345	182.169	183.143	175.560
- me mjek	124.994	101.938	111.288	111.516	97.897
Numri i vizitave të para-obsetrikale	29.517	28.178	23.636	25.900	23.444

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Konsultori i fëmijëve

Në vitin 2022, në konsultorin e fëmijëve u regjistruan 266.362 fëmijë dhe u kryen 749.118 vizita, mesatarisht 2,8 vizita për fëmijë në vit. Krahasuar me vitin 2021, numri i vizitave është rritur me 0,5 %. Nga totali i vizitave, 56,5 % e tyre u realizuan me asistencë të mjekut specialist dhe pjesa tjetër me asistencë të mamive dhe infermierëve.

Numri i fëmijëve 0-1 vjeç që ushqehen vetëm me gji gjatë vitit 2022 ishte 17.849, ndërsa numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me ushqim artificial ishte 4.719.

Tab. 3 Konsultori i Fëmijëve

Emërtimi	Vitet				
	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i konsultoreve të fëmijëve	2.131	2.081	2.028	2.055	2.124
Numri i vizitave në konsultor	802.633	782.532	708.211	745.746	749.118
nga këto: sa nga mjeku	455.987	423.412	410.153	414.282	422.998
Numri i fëmijëve të regjistruar në konsultor	253.403	276.306	256.146	257.054	266.362
Numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me gji	18.988	18.317	18.541	19.660	17.849
Numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me ushqim artificial	5.342	4.585	4.239	4.597	4.719

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në vitin 2022, vaksinimi i fëmijëve brenda vitit të parë të jetës sipas skemës kombëtare të vaksinimit vazhdon të jetë i lartë për të gjitha llojet e vaksinave. Këtë vit vërehet një ulje e mbulesës vaksinale ndaj Difterisë, Tetanozit dhe Pertusit me 0,8 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021.

Tab. 4 Mbulimi vaksinal, në %

Emërtimi	Vitet				
	2018	2019	2020	2021	2022
Fëmijë të vaksinuar për:					
– Tuberkuloz	99,1	98,9	97,9	98,8	98,7
– Difteri	99,8	98,6	98,5	95,8	95,0
– Tetanoz	99,8	98,6	98,5	95,8	95,0
– Pertusis	99,8	98,6	98,5	95,8	95,0
– Fruth-Rubeolë-Parotit	94,1	95,0	91,0	89,2	89,2
– Poliomit	98,7	98,6	98,3	98,0	98,0

Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

II. Shërbimi spitalor dytësor

Në vitin 2022, numri i spitaleve publik dhe jopublik në vend ishte 61, nga të cilët 43 janë spitale publike dhe 18 spitale private. Mbulimi i shërbimit spitalor publik dhe jopublik ishte 2,2 spitale për 100 mijë banorë.

Në institucionet publike të shërbimit spitalor, në vitin 2022 numri i të shtruarve ishte 280.730 pacientë. Shfrytëzimi i shtratit në ditë për kujdes shëndetësor gjatë vitit 2022 ishte 158,2 ditë, të cilat përbëjnë 43,3 % të ditëve kalendarike të këtij viti.

Tab. 5 Tregues të aktivitetit në institucionet publike të shërbimit spitalor

Treguesit e aktivitetit në Spitale Publike	Vitet				
	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i institucioneve spitalore	42	42	42	43	43
Numri i shtretërve në total ¹	8.496	8.586	8.745	8.926	8.703
Të shtruar në institucione	279.018	282.962	201.449	244.784	280.730
Ditë-shtretër të realizuar	1.528.499	1.491.930	1.032.922	1.248.197	1.272.322
Shfrytëzimi i shtratit në ditë	186,7	182,2	123,9	146,8	158,2
- në %	51,2	49,9	34,0	40,2	43,3
Ditë qëndrimi mesatar të sëmurit në spital	5,5	5,3	5,0	5,1	4,6
Xhiro e shtratit ²	33,9	34,4	24,9	28,7	34,6
Të sëmurë të operuar gjithsej	64.929	63.669	46.369	56.622	63.862


Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

¹ Të dhënat janë rishikuar; Në numrin total të shtretërve përfshihen edhe shtretërit e urgjencës, shtretërit kurativë akute që ofrojnë shërbim spitalor.

² Të dhënat janë rishikuar për shkak të ndryshimeve në metodologjinë për llogaritjen e të dhënave bazuar në metodologjinë e Eurostat.

Ditët e qëndrimit mesatar të një pacienti janë 4,6 ditë në vit me një xhiro të shtratit 34,6 herë pacientë në vit.


Fig. 2 Pacientë të dalë dhe ditë mesatare të qëndrimit në institucionet publike të shërbimit spitalor



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në vitin 2022, nga totali i pacientëve të shtruar, u kryen 63.862 ndërhyrje kirurgjikale, me një rritje me 12,8 % krahasuar me vitin paraardhës. Nga totali i operacioneve të kryera, përafërsisht gjysma e operacioneve i përkasin shërbimit të kirurgjisë (46,4 %).

Fig. 3 Shpërndarja e ndërhyrjeve kirurgjikale sipas shërbimeve, në %



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Metodologjia

Botimi “Treguesit e Shëndetit Publik” përmban të dhëna administrative mbi shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimin spitalor dytësor, me frekuencë vjetore. Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërkohë të dhënat mbi shërbimin vaksinal kanë burim informacioni Institutin e Shëndetit Publik.

Përkufizime

Qendrat e kujdesit shëndetësor parësor janë të gjitha institucionet shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për pacientët në mënyrë ambulante, të cilat janë të pajisura me të paktën një personel mjekësor, mjek ose infermier (nuk përfshihet shërbimi i stomatologjisë).

Kujdesi shëndetësor parësor i ofrohet popullatës nga njësi bazë e tij, që njihet si qendra shëndetësore kryesore, në nivel qyteti dhe qendër njësie administrative, dhe nga ambulance ose pika shëndetësore, në nivel fshati, duke synuar mbulimin sa më të gjerë dhe aksesin në shërbim shëndetësor të popullatës, si pika e parë e kontaktit me sistemin kombëtar të kujdesit shëndetësor.

Spitali është një rezidencë institucionale që ofron kujdes mjekësor, hoteleri-24 orë, diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve që mund të kenë nevojë për ndihmë mjekësore ose kirurgjikale.

Shtretër spitalorë janë shtretër për akomodimin e pacientëve, ku përfshihen katër tipe shtretëresh sipas funksionit: shtretër kurativë, shtretër rehabilitues, shtretër kronikë dhe paliativë si dhe shtretër të tjerë të paklasifikuar. Totali i numrit të shtretërve i referohet numrit në të gjitha spitalet, përfshirë spitalet e përgjithshme, spitalet e shëndetit mendor dhe të abuzimit me substancat, spitalet e specialitetit, pavarësisht nëse krevati është i zënë apo jo.

Të shtruar janë pacientë të cilët janë pranuar formalisht në një institucion për trajtim ose kujdes, dhe që qëndrojnë minimumi një natë.

Shfrytëzimi i shtratit në ditë është numri i ditëve mesatare të vitit gjatë të cilave një shtrat i spitalit është i zënë me pacientë.

Ditë shtretër të realizuar është shumëzimi i shfrytëzimit të shtratit në ditë me numrin e shtretërve në spital.

Xhiro e një shtrati është numri i të sëmurëve që janë shtruar në një shtrat gjatë vitit.